



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, , si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

**Neni 1
Përbërja**

Formohet Komisioni i cili do të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë së objekteve të banimit-banesave në pronësi shoqërore në Magurë në përbërje si vijon:

1. Bajram Sinani, kryesues nga Drejtorati për Planifikim dhe Urbanizëm
2. Kushtrim Salihu, anëtar nga Drejtorati Shërbimeve Publike
3. Gafurr Hetemi, anëtar nga Sektori pronësor -juridik

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrë e Komisionit është të bëjë vlersimin e rrezikshmerisë së objekteve të banimit-banesave në pronësi shoqërore në Magurë menjëherë pas pranimit të këtij Vendimi .

Pas konstatimit të gjendjes faktike, Komisioni duhet të përgadisë raport me shkrim të cilit i bashkëngjitet procesverbali dhe fotografitë nga tereni dhe të njëjtin duhet tia dorëzojë Kryetarit të Komunës.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 360-48062
Lipjan, më 5.10.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

